



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0152

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga, Isa Hasani-kryetar, duke vendosur sipas ankesës së (OE) “RED by Besa Security” L.L.C., kundër vendimit për anulimin e procedurës së prokurimit të “KK PRIZREN” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizimi dhe montimi dhe mirëmbajtja e kamerave nëpër objektete e kujdesit parësor shëndetësor në Komunën e Prizrenit” me numër të prokurimit; 622-23-4818-1-2-1, me 29/05/2024, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE “RED by Besa Security” L.L.C. me nr. 2024/0152 , e datës 22/02/2024, kundër Vendimit AK- Komuna Prizren, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizimi dhe montimi dhe mirëmbajtja e kamerave nëpër objektete e kujdesit parësor shëndetësor në Komunën e Prizrenit” me numër të prokurimit; 622-23-4818-1-2-1
2. Mbetet në fuqi “Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues” datës, 05.02.2024, i Autoritetit Kontraktues, Komuna e Prizren, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizimi dhe montimi dhe mirëmbajtja e kamerave nëpër objektete e kujdesit parësor shëndetësor në Komunën e Prizrenit” me numër të prokurimit; 622-23-4818-1-2-1.
3. Meqenëse ankesa e OE ankues “RED by Besa Security” L.L.C., aprovohet si pjesërisht e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale --

Me 06.05.2023, Komuna Prizrenit, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Furnizimi dhe montimi dhe mirëmbajtja e kamerave

nëpër objektete e kujdesit parësor shëndetësor në Komunën e Prizrenit” me nr. të prokurimit: 622-23-4818-1-2-1. Ndërsa me datën 05.02.2024 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues me të cilin ka anuluar aktivitetin e prokurimit. .

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: - Furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 50,000 €.

Me 09.02.2024, OE “RED by Besa Security” L.L.C., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Më 12.02.2024, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar kërkesën si të bazuar.

Me 22.02.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “RED by Besa Security” L.L.C., me nr. 2024/0152 për lidhur me aktivitetin “Furnizimi dhe montimi dhe mirëmbajtja e kamerave nëpër objektete e kujdesit parësor shëndetësor në Komunën e Prizrenit” me nr. të prokurimit: 622-23-4818-1-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

-Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “RED by Besa Security” L.L.C., janë parashtruar si në vijim:

Me datën 05.02.2024 në platformën e-prokurimi kemi pranuar dokumentin me titull B58 – Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, për tenderin në fjalë. Ky vendim erdhi si rezultat i rivlerësimit, pasi që 2 vendimet e kaluara u anuluan me vendim të OSHP, si rrjedhojë e vendimeve arbitrare të autoritetit kontraktues. Si i vetmi operator ekonomik i cili ka marrë kohën dhe mundim duke ofertuar me produkte të zgjedhura që i përmbushin të gjitha kriteret e këtij projekti, ne e parashtruam për herën e 3-të kërkesën tonë për rishqyrtim për këtë aktivitet, ndaj autoritetit kontraktues. Megjithatë, duke e përsëritur avazin e vjetër, sërish zyrtarët kompetent të autoritetit kontraktues nuk morën mundimin që ti shqyrtojnë pretendimet tona, dhe refuzuan kërkesën tonë për rishqyrtim. Kësisoj, AK ka rënë sërish ndesh me Nenin 108/A të LPP-së. Përveç kësaj, është për keqardhje mënyra e arsyetimit për refuzim, të cilin do ta citojmë në origjinal

Andaj, duke kërkuar gjithmonë të drejtën tonë dhe duke qenë të bindur se Autoriteti Kontraktues po bie ndesh po ashtu me Nenin 1 të LPP-së dhe Nenin 7 të LPP-së, kemi vendosur që të bëjmë ankesë tek ju si Organi Shqyrtues i Prokurimit. Në vijim, do ti sqarojmë pretendimet tona, të cilat i kemi elaboruar edhe në kërkesën për rishqyrtim

Arsyeja e eliminimit, Pozicioni nr 1.7 – Specifikimet Teknike që nevojiten për UPS 800VA/480W: - Mungon në specifikimet teknike në broshurë – Niveli i zhurmës < 30 dB. Pozicioni nr 1.8 – Specifikimet Teknike që nevojiten për UPS 1000VA/600W: - Mungon në specifikimet teknike në broshurë – Niveli i zhurmës < 30 dB. KUNDËRPËRGJIGJA JONË Të nderuar, Modeli i ofertuar i UPS është PowerWalker VI 600-1000 MS, ku i kemi nënvizuar në katalog të dy modelet, 800VA/480W dhe 1000VA/600W. Mos të kishte qenë qëllimi i AK vetëm eliminimi jonë, por vlerësimi i mirëfilltë i ofertës, do të vepronin njëjtë sikur me eliminimin e Fati Security që kanë paraqitur linqet zyrtare online, dhe do ta vërenin se UPS jonë e ka nivelin e zhurmës sipas kërkesës, < 30 dB. Këtë mund ta verifikoni në websajtin zyrtar me një kërkim të thjeshtë në Google: <https://powerwalker.com/product/10121160/> Pra, nga elaborimi i mësipërm, vërehet qartë se e përmbushim këtë kriter dhe AK nuk e ka shqyrtuar katalogun si duhet, andaj, pretendimi i autoritetit kontraktues nuk qëndron.

2) Arsyeja e eliminimit, Pozicioni nr 1.9 – Specifikimet Teknike që nevojiten për Rack Kabinet: - Mungon në specifikimet teknike në broshurë – 3 dyert me qels KUNDËRPËRGJIGJA JONË Të nderuar, Modeli i ofertuar i Rack Kabinet posedon 3 dyer me çelës, gjë që vërehet edhe në katalogun e dorëzuar, por AK gjithmonë vendos të mbyll sytë kur bëhet fjalë për kompaninë tonë, e kjo edhe mund të verifikohet edhe në linkun zyrtar: <https://lanberg.pl/en/produkt/WF01-6404-10B> Edhe në këtë rast, nga elaborimi i mësipërm, vërehet qartë se e përmbushim këtë kriter dhe AK nuk e ka shqyrtuar katalogun si duhet, andaj, pretendimi i autoritetit kontraktues nuk qëndron.

3) Arsyeja e eliminimit, Pozicioni nr 4.0 – Specifikimet Teknike që nevojiten për Switch PoE: - Mungon në specifikimet teknike në broshurë – AUTO MDI/MDIX, kapaciteti 1.8 Gbps - Mungon në specifikimet teknike në broshurë – For Full-Duplex Mode And Backpressure for Half-Duplex Mode - Mungon në specifikimet teknike në broshurë – i certifikuar FCC, CE, RoHS KUNDËRPËRGJIGJA JONË Të nderuar, Modeli i ofertuar i Switchit PoE i përmban të gjitha specifikat e mësipërme, të gjitha janë të shënuara në katalogun e dorëzuar. Po ashtu, të gjithë produktet e UNV i kanë certifikatat për treg European. Të njëjtat certifikata të kërkuara për switcha PoE do ti bashkangjesim si dokument shtojcë. Pra, nga elaborimi i mësipërm, vërehet qartë se e përmbushim këtë kriter dhe AK nuk e ka shqyrtuar katalogun si duhet, andaj, pretendimi i autoritetit kontraktues nuk qëndron.

4) Arsyeja e eliminimit, Pozicioni nr 4.1 – Specifikimet Teknike që nevojiten për NVR: - Mungon në specifikimet teknike në broshurë – i mungon protokollu sipas AK - Mungon në specifikimet teknike në broshurë – 60 MBPS (OE ka ofruar 64 MBPS). - Mungon në specifikimet teknike në broshurë – VIGI Regjistruar video në rrjet - Mungon në specifikimet teknike në broshurë – Instalim i shpejtë GuideO KUNDËRPËRGJIGJA JONË Të nderuar, Keni kërkuar protokollet TCP/IP, DHCP, DNS, NTP, UPnP – të gjitha këto protokolle lexojnë në katalogun e dorëzuar: Keni kërkuar bandwidth 80 Mbps / 60 Mbps, kemi ofertuar me 80 Mbps / 64 Mbps, që i tejkalon specifikat tuaja: VIGI regjistruar në rrjet – është model i regjistruar në rrjet (anglisht: network video recorder apo NVR) i modelit të TP Link. Normalisht që ky emërtim nuk gjendet në asnjë produkt tjetër përveç të atij të TP Link. Ne kemi ofertuar me brendin Uniview, modeli i të cilit është NVR501-B dhe nuk mund të jetë VIGI pasi që nuk është emërtim i Uniview. Andaj, vetëm shënimi i kësaj nga ana e AK është skandaloz! E njëjta vlen edhe për të fundit, instalim i shpejtë GuideO. Të gjitha produktet e UNV kanë quick guide installation dhe të pretendohet të përdoret një gjë e tillë për eliminim, është qesharake. Edhe në këtë rast, nga elaborimi i mësipërm, vërehet qartë se e përmbushim këtë kriter dhe AK nuk e ka shqyrtuar katalogun si duhet, andaj, pretendimi i tyre, përveç se është skandaloz, ai po ashtu nuk qëndron.

5) Arsyeja e eliminimit, Pozicioni nr 4.2 – Specifikimet Teknike që nevojiten për IP Camera: - Mungon në specifikimet teknike në broshurë – Horizontal FOV: 102°, (OE Red+Besa e ka dhanë FOV 112.9) - Mungon në specifikimet teknike në broshurë – vertical FOV: 55°, (OE Red+Besa e ka dhanë FOV 59.1) - Mungon në specifikimet teknike në broshurë – Shpejtësia e bitit të videos: Transmetimi kryesor: 256 Kbps to 4 Mbps (OE Red+Besa e ka dhanë 128-16 Mbps) KUNDËRPËRGJIGJA JONË Të nderuar, Edhe këtu kemi pretendime skandaloze, kemi kërkuar kënd të pamjes horizontale 102 shkallë, ne kemi ofruar kamerë me kënd më të madh të pamjes dhe më të mirë, 112.9 shkallë. Keni kërkuar kënd të pamjes vertikale 55 shkallë, kemi ofruar kamerë me kënd më të madh të pamjes dhe më të mirë, 59.1 shkallë. Keni kërkuar transmetim nga 256 Kbps deri në 4 Mbps, ne kemi ofruar transmetim më të gjerë që e mbulon edhe 256 Kbps dhe e tejkalon 4 Mbps, pra prej 128 Kbps deri në 16 Mbps. Për të bërë dallimin, shtrirja e vargut sipas kërkesës tuaj mbulon vetëm 4000 Kbps, ndërsa, tek pajisja e ofruar nga ne, shtrirja e vargut mbulon 16000 Kbps. Edhe në këtë rast, nga elaborimi i mësipërm, vërehet qartë se e përmbushim këtë kriter, andaj, pretendimi juaj, përveç se është skandaloz, ai po ashtu nuk qëndron.

6) Arsyeja e eliminimit, Pozicioni nr 1.4 – Specifikimet Teknike që nevojiten për Monitor Brand Name FHD 24”: - Mungon në specifikimet teknike në broshurë – Spiker - stereo 2Watt, NearEdgeless edge. - Mungon në specifikimet teknike në broshurë – 1xAudio Out (3.5 mm). Të nderuar, Në këtë pozicion, tek monitorët që do të përdoren për monitorimin e kamerave në kohë reale, të cilët do të lidhet drejtpërdrejt me NVR, po kërkon që monitori të ketë audio. Vet kërkesa si e tillë, bie ndesh me Ligjin Nr. 06/L-082

për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Mirëpo, për të qenë më të saktë në këtë, ne kemi kërkuar sqarim nga institucioni kompetent për zbatim të Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, që është Agjencia për Informim dhe Privatësi. Pyetja jonë ishte se a lejohet që monitori për qëllimin e mësipërm, të ketë altoparlant për transmetim të zërit. Nga Agjencia për Informim dhe Privatësi e morrëm konfirmimin se vendosja e një sistemi të tillë nuk është në harmoni me dispozitat e LMDhP-së. Andaj, si rrjedhojë, përderisa të gjitha specifikat tjera përmbushen nga monitori i ofruar dhe nga të gjitha pajisjet tjera të ofertuara në këtë tender, si dhe duke marrë parasysh që altoparlantat për këta monitora, përveç se nuk guxojnë të përdoren dhe bien ndesh me Ligjin e mësipërm, ato nuk ndikojnë aspak në performancën e sistemit. Ju njoftojmë për një vendim të OSHP-së të ngjashëm (për referencën tuaj vendimi 0750/2023), ku OSHP në një aktivitet të ngjashëm me kamera, për një specifikë që nuk ishte përmbushur nga produkti, e kjo specifike nuk kishte ndikuar fare në performancën dhe kualitetin e sistemit, paneli shqyrtues i OSHP kishte vendosur në favor dhe t'i lejoj ato specifika.”

Duke u referuar pretendimeve si më sipër “RED by Besa Security” L.L.C., konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, Nenin 7, Nenin 59, dhe Nenin 60 të LPP-së, e po ashtu me Nenin 108/A, duke mos e anuluar vendimin e datës 05.02.2024, dhe të na shpallin neve, si tenderuesit e vetëm të suksesshëm në këtë aktivitet.

-Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim:

“RED by Besa Security” L.L.C., “Komisioni Vlerësues i AK duke u bazuar në ekspertizën e ekspertit të OSHP-së edhe në vendimin e PSH me nr.2023/0861 ka bërë Ri-vlerësimin e ofertave.

Komisioni Vlerësues i Njësisë Kërkuese pas Ri-vlerësimit të ofertave tek OE RED by Security L.L.C ka has në mospërputhje me specifikimet teknike të OE të dorëzuara me ato Autoritetit Kontraktues si më poshtë:

Pozicioni 1.4 Specifikimet Teknike qe nevojiten për Monitor Brand Name FHD 24” : 1. Mungon në specifikimet teknike në broshurë - Spiker - stereo 2Watt, NearEdgeless edhe. 2.Mungon në specifikimet teknike në broshurë - 1xAudio Out (3.5 mm),

Pozicioni NR 1.7 Specifikimet Teknike qe nevojiten për UPS 800VA/480W: 1.Mungon në specifikimet teknike në broshurë - Niveli i zhurmës < 30dB,

Pozicioni NR 1.8 Specifikimet Teknike qe nevojiten për UPS 1000VA/600W: 1.Mungon në specifikimet teknike në broshurë - Niveli i zhurmës < 30dB,

Pozicioni NR 1.9 Specifikimet Teknike qe nevojiten Rack kabinet: 1.Mungon në specifikimet teknike në broshurë - 3 dyert me qels,

Pozicioni NR 4.0 Specifikimet Teknike qe nevojiten Switch PoE: 1.Mungon në specifikimet teknike në broshurë - AUTO MDI/MDIX, kapaciteti 1.8 Gbps, 2. Mungon në specifikimet teknike në broshurë - For Full-Duplex Mode And Backpressure for Half-Duplex Mode, 3.Mungon në specifikimet teknike në broshurë - i certifikuar FCC, CE, RoHS

Pozicioni NR 4.1 Specifikimet Teknike qe nevojiten NVR: 1. Mungon në specifikimet teknike në broshurë - i mungon protokolli sipas AK 60MBPS, (OE Red+ Besa ka ofruar në specifikat e tij 64Mbps), 2. Mungon në specifikimet teknike në broshurë - VIGI Regjistruar video në rrjet, 3. Mungon në specifikimet teknike në broshurë - Instalim i shpejtë GuideO ,

Pozicioni NR 4.2 Specifikimet Teknike qe nevojiten IP Camera: 1.Mungon në specifikimet teknike në broshurë - Horizontal FOV: 102°, (OE Red+Besa e ka dhanë FOV 112.9), 2.Mungon në specifikimet teknike në broshurë - vertical FOV: 55°, (OE Red+Besa e ka dhanë FOV 59.1), 3. Mungon në specifikimet teknike në broshurë - Shpejtësia e bitit të videos: Transmetimi kryesor: 256 Kbps to 4 Mbps (OE Red+Besa e ka dhanë 128-16 Mbps).”

OE RED by Security L.L.C në arsyetimet e tij në Kërkesën për Shqyrtim në AK se ka dorëzuar specifitime teknike më kapacitete ma të mëdhaja për pajisje për kamera konform specifikat teknike të kërkuara nga Autoritet Kontraktues, NUK QËNDROJNË sepse gjatë Njoftimit në Kontratë nuk kemi pasur kërkesë për sqarim në TD nga Operatori Ekonomik ankues lidhur me ndonjë specifik teknike të pretenduar për kamera.

OE RED by Security L.L.C nuk përmbushë specifikimet teknike si më lart shënuar në katalogët e tij konform specifikave teknike të kërkuara nga Autoriteti kontraktues. Nenin 72 dhe nenin 59 të LPP-së.”

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 27.02.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 00152/24, ndërsa me datë 12.03.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/0152 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Duke marr parasysh sqarimet e lartpërmendura, ekspertit shqyrtues ka mendim ndaras nga eksperti teknik, sipas ekspertit shqyrtues kthimi i lëndës në rivlerësim, vlerësoj që nuk mund të ndryshoj rezultatin përfundimtar për shkak të arsyetimeve të cilat janë dhënë nga ekspertët. Atëherë eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, ndërsa Vendimi i AK-së të mbetet në fuqi.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK Pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtuese, ndërsa OE Nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

-Vlerësimi pretendimit ankimor te OE “RED by Besa Security” L.L.C., - eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/0152 ka vlerësuar si në vijim:

Sqarim hyrës: Pretendimet e OE ankues të cilat kanë karakter ankimor teknik, për të njëjtat është përgjigjur eksperti teknik.

Eksperti teknik pas administrimit të dokumentacionit lidhur me pretendimet ankimore të OE ankues kundrejt vendimit të AK sqaron:

Pretendimi i pare pika 1 ka te beje me pozicionin nr 1.7 te specifikimeve teknike, gjegjësisht mungesa e te dhënave ne broshurën e ofertuar për nivelin e zhurmës i cili duhet te jete <30dB tek UPS 800VA/480W.

Pas shqyrtimit te katalogut te ofruar ne ofertën e OE ankues vërehet se mungojnë te dhënat te cilat dëshmojnë lidhur me nivelin e zhurmës, si do te jete AK ka mundur te kërkoj sqarime shtese ne këtë çështje, megjithëse pas surfimit ne internet ne faqen zyrtare te produktit te ofertuar VI 600 MS-BlueWalker, munde te vërehet se plotësohet ky kusht, pra pajisja e ofertuar e ka nivelin e zhurmës me te vogël se 30db. Prandaj bazuar ne sqarimin e mësipërm pretendimi ankimore i OE ankues është i Bazuar.

Pretendimi i pare pika 2 ka te beje me pozicionin nr 1.8 te specifikimeve teknike, gjegjësisht mungesa e te dhënave ne broshurën e ofertuar për nivelin e zhurmës i cili duhet te jete <30dB tek UPS 1000VA/480W.

Pas shqyrtimit te katalogut te ofruar ne ofertën e OE ankues vërehet se mungojnë te dhënat te cilat dëshmojnë lidhur me nivelin e zhurmës, si do te jete AK ka mundur te kërkoj sqarime shtese ne këtë çështje, pas surfimit ne internet (<https://powerwalker.com/product/10121160/>) ne faqen zyrtare te produktit te ofertuar VI 600 MS-BlueWalker, mund te vërehet se plotësohet ky kusht, pra pajisja e ofertuar e ka nivelin e zhurmës me te vogël se 30db. Prandaj bazuar ne sqarimin e mësipërm pretendimi

ankimore i OE ankues është i Bazuar.

Pretendimi i dyte, ka te beje me pozicionin 1.9 te specifikimeve teknike, gjegjësisht mungesa e te dhënave ne katalog/broshur lidhur me 3 dyer te rack kabinetit te jene me çelës.

Pas shqyrtimit te dokumentacionit, kërkesave te DT, ofertës se OE ankues lidhur me këtë çështje, dhe surfimit ne internet (<https://lanberg.pl/en/produkt/WF01-6404-10B#img10>) sa i përket pajisjes se ofertuar mendoj se pajisja, rack kabinet posedon tri (3) dyer me çelës. Prandaj bazuar ne sqarimin e dhënë me sipërm pretendimi ankimore i OE ankues është i bazuar.

Pretendimi i trete ka te beje me pozicionin 4 te specifikimeve teknike sa i përket PoE Network Switch lidhur me AUTO MDI/MDIX, kapaciteti 1.8 Gbps, For Full-Duplex Mode And Backpressure for Half-Duplex Mode.

Pas shqyrtimit te kërkesave te DT, specifikimeve teknike, katalogut te OE ankues, surfimit ne internet lidhur me këtë pajisje Poe Switch NSW081P te prodhuesit Uniwievtetec ne faqen e prodhuesit(https://www.univiewtechnology.com/wpcontent/uploads/2020/01/NSW081P_UVT6311118-01_final.pdf) nuk ka te dhëna te cilat dëshmojnë se pajisja e tillë ka kapacitet prej 1.8 Gbs për të lejuar lidhjen automatike midis dy pajisjeve siç është kërkuar ne DT(AUTO MDI/MDIX, kapaciteti 1.8 Gbps), po ashtu nuk dëshmohet as ne katalogun e ofertuar e as ne linkun e me sipërm se pajisja e tille ka mekanizmin e kërkuar për te menaxhuar trafikun dhe për të ndaluar konfliktet në transmetimet e të dhënave në rrjetet me shpejtësi të ndryshme siç është kërkuar ne DT (Backpressure for Half-Duplex Mode), pasi që pajisja e ofertuar ofron kapacitet te transmetimit prej 3.6 Gb/s dhe se kërkesat tjera teknike pajisja e ofertuar i plotëson, është ne diskrecion të AK aplikimi i nenit 59.2.

Lidhur me certifikatat e kërkuara ne DT, pas shqyrtimit të ofertës se OE ankues, dhe të dhënave ne e-prokurim, me gjithë deklarimin e OE ankues ne ankesën e parashtruar, se do të i bashkëngjis certifikatat qe dëshmojnë se pajisjet kanë markimin CE, eksperti teknik nuk ka mundur të i gjej ne e-prokurim.

Prandaj bazuar ne sqarimet e dhëna me sipër lidhur me këtë pretendim, mendoj se pretendimi i OE ankues kundrejt vendimit të AK është i pa bazuar.

Pretendimi i katërt ka të beje me pozicionin 4.1 të specifikimet teknike sa i përket NVR, lidhur me mungesën e protokolleve, VIGI, kapaciteti i transmetimit 60 Mbps dhe instalimi i shpejte GuideO.

Pas shqyrtimit të katalogut ne ofertën e OE ankues, surfimit ne internet ne faqen e prodhuesit (<https://global.uniview.com//Products/NVR/Prime/NVR501-B-Series/>) dhe manualit te përdorimit (<https://global.uniview.com/download.do?id=1894040>) pajisja e ofertuar NVR501-B është pajisje e cila i përmbush kërkesat e DT, posedon protokollet e kërkuara, tejkalon kërkesën për Outgoing bandwidth 64Mbps dhe një ashtu çdo pajisje e tille posedon quick gude installation, sic potencohet ne manualin e përdorimit, linkun e te cilit e kam cekur me larte.

Sa i përket kërkesës në DT, për VIGI regjistruet video ne rrjet, kjo kërkesë ngushton konkurrencën pasi si e tille është linje e dedikuar e një prodhuesi te vetëm (Tp-linkut), megjithëse pajisja e ofertuar nga OE ankues plotëson kërkesat e DT, pra është pajisje qe shërbet për ruajtjen dhe regjistrimin e videove ne rrjet. Prandaj bazuar ne sqarimet e dhëna me sipërm, mendoj se pretendimi ankimor i OE ankues kundrejt vendimit te AK është i Bazuar.

Pretendimi i pestë ka të bejë me pozicionin 4.2 tek specifikimet teknike sa i përket IP Cameres lidhur me mungesën e Horizontal FOV 102°, mungon Vertical FOV 55° dhe shpejtësia e transmetimit 256 kbps to 4 Mbps.

Pas shqyrtimit te dokumentacionit te ofertuar, katalogut te pajisjes, IP Camera IPC2124LE-ADF28(40)KMC-WL dhe te dhenave tjera ne faqen e prodhuesit ([https://global.uniview.com//Products/Cameras/Easy/IPC2124LE-ADF28\(40\)KMC-WL/](https://global.uniview.com//Products/Cameras/Easy/IPC2124LE-ADF28(40)KMC-WL/)), kamera e tille

jo qe plotëson kërkesat e DT, por tejkalon këto karakteristika, pra kemi te bëjmë me një pajisje me kënde me te gjera te videoregjistrimit dhe kapacitet me te gjere te transmetimit. Prandaj bazuar ne këto sqarime pretendimi ankimore i OE ankues kundrejt vendimit te AK është i Bazuar.

Pretendimi i gjashtë ka të bëjë me pozicionin 1.4 të specifikimet teknike sa i përket Monitor BrandName FHD 24inch lidhur me mungesën e Spiker-stereo2Watt, nearEdgeless.

Pas shqyrtimit te dokumentacionit, katalogut te ofertuar për pajisjen DELL 24 SE2422H, dhe te dhënave tjera ne faqen e prodhuesit Dell (<https://www.dell.com/en-us/shop/dell-24-monitor-se2422h/apd/210-ayxt/monitors-monitor-accessories>), pajisja e ofertuar nuk posedon mundësin Spiker-stereo2Watt, nearEdgeless., prandaj si e tillë ne aspektin teknik nuk plotëson kërkesën e DT. Prandaj bazuar ne sqarimin e dhënë me sipër pretendimi ankimore i OE ankues kundrejt vendimit te AK është i pa Bazuar.

Eksperti shqyrtues sqaron se sa i përket pjesës ku është kërkuar specifikimi teknik për pajisjen Audio Out dhe i njëjti nuk është ofruar nga OE ankues me arsyetimin se një gjë e tillë bie në kundërshtim me Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sipas ekspertit një çështje e tillë shumë me rëndësi është dashur të ngritje në fazën e parë, përkatësisht ankesa të parashtrohej në kritere nëse ka dyshime të tilla. Në rastin kur OE ankues nuk ka parashtruar asnjë ankesë/kërkesë për rishqyrtim në lidhje me këto kritere të DT-së dhe OE ankues ka ofertuar duke e ditur se duhet të dorëzoj katalogjet dhe specifikimet teknike për secilin produkt/pajisje të kërkuar në DT, atëherë konsiderojmë që OE ankues është pajtuar me këto kritere dhe prandaj edhe ka zgjedhur të procedoj tutje. Ofertimi me këtë pajisje ka qenë kërkesë e DT-së dhe e njëjta është dashur të përmbushej nga OE ankues. Sipas Udhëzuesit për Prokurimin Publik, pika 10, në rastin kur nuk dorëzohet specifikacioni teknik atëherë AK duhet të refuzoj tenderin pa kërkuar informacione të mëtejshëm, e që në rastin konkret mungon për këtë pajisje.”

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues “RED by Besa Security” L.L.C., Argumentimi në raportin e ekspertit shqyrtuese është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues “RED by Besa Security” L.L.C., janë pjesërisht të bazuara.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Rregullorja e Punës së Organit të Shqyrtimit Publik, e cila gjendet e publikuar në Webfaqen e OSHP-së, me nenin 20, paragrafi 2 të Rregullores, përcakton kërkesat për Autoritetin kontraktues dhe Operatorin ekonomik, që të gjitha informatat dhe njoftimet duhen të dorëzohen dhe komunikohen përmes platformës së komunikimit publik, nëse kjo është e mundur.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtrësas e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjera, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqkimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues “RED by Besa Security” L.L.C , Argumentimi në raportin e ekspertit shqyrtues është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues “RED by Besa Security” L.L.C janë pjesërisht të bazuara.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e “Furnizimi dhe montimi dhe mirëmbajtja e kamerave nëpër objektete e kujdesit parësor shëndetësor në Komunën e Prizrenit” me nr. të prokurimit: 622-23-4818-1-2-1.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik “RED by Besa Security” L.L.C., te aprovohet si pjesërisht e bazuar. Përfundimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të vërtetuar, Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – Komuna Prizren, të datës 05.02.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizimi dhe montimi dhe mirëmbajtja e kamerave nëpër objektete e kujdesit parësor shëndetësor në Komunën e Prizrenit” me nr. të prokurimit: 622-23-4818-1-2-1, dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK-së.

Paneli shqyrtues duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjelloj sërish në detaje dhe pa nevojë në këtë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues. Krahas tjerash në raportin e ekspertit shqyrtues janë dhënë shpjegime profesionale dhe të argumentuara pa vërejtje lidhur me pohimet ankimore, prandaj Paneli shqyrtues mbështet vlersimet dhe rekomandimin e ekspertit shqyrtues.

Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), natyrisht në pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK në rastin konkret ka pasur të drejtë të vendos po ashtu edhe për OE të rekomanduar për dhënie të kontratës bazuar edhe në neni 24 paragrafi 2 të LPP cituar “Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj”.

Paneli shqyrtues bazuar në faktin e aprovimit të përsëritshëm të ankesës të OE “RED by Besa Security” L.L.C, vendosi të kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 4 të Rregullores së Punës së OSHP.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, dhe nenin 105 nenin të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT**
- **OE - RED by Besa Security L.L.C.**
- Arkivës së OSHP-së: